



Fides

Çmimi për Filantropinë Korporative
2008-2009

Ceremonia e ndarjes së Çmimit FIDES

1 dhjetor 2009, Prishtinë



Ceremonia e ndarjes së Çmimit FIDES

1 dhjetor 2009, Prishtinë



Filantropia korporative nënkupton përkrahjen nga kompanitë/ndërmarrjet për organizatat ose institucionet jofitimprurëse, institucionet e kulturës, atyre të mbrojtjes sociale dhe shëndetësore, me para, prodhime ose shërbime. Filantropia korporative është pjesë e përgjegjësisë shoqërore të afarizmit, dhe bën ndërlidhjen ndërmjet fushës së filantropisë dhe përgjegjësisë shoqërore të afarizmit.

PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE E AFARIZMIT (corporate social responsibility)

Është një koncept gjerësisht i kuptuar i menaxhimit të kompanisë, i cili "ruan baraspeshën mes qëllimeve ekonomike dhe shoqërore" me qëllim të vendosjes së standardeve më të larta të jetesës, krahas ruajtjes së profitabilitetit të kompanisë, për njerëzit në kompani dhe jashtë saj". Përgjegjësia shoqërore e afarizmit nënkupton që kompanitë/ndërmarrjet sillen në mënyrë etike, i respektojnë ligjet, të punësuarit, konsumatorët klientë, partnerët dhe furnizuesit.





...angazhim i sinqertë për një besim të ndërsjellë...



Çmimi FIDES i dhurohet kompanisë e cila në mënyrë sistematike dhe të kujdesshme përkrahë aktivitetet dhe projektet e interesit të përbashkët. Kjo është kompani që ka një strategji ekzistuese për të investuar në të mirën e përbashkët. Drejtimi filantropik i kompanisë mund të shërbej si model i suksesshëm dhe inspirues për investimet strategjike në komunitet me ç'rast një qasje e tillë është e mishëruar në projektet më të rëndësishme që kompania ka përkrahur gjatë vitit.

Objektiv i këtij çmimi prestigjioz është që të bëjë publik emrat e kompanive apo ndërmarrjeve, të cilat kanë dhënë përkrahje financiare për format e ndryshme të organizimit jo-profitabil dhe për idetë e komunitetit që kanë kontribuar për të mirën e përbashkët. Në këtë mënyrë FIDES paraqet një model, i cili do të ndiqet nga bota e biznesit.

Organizimi i dhënies së çmimit dhe vetë ceremonia, është një mundësi ideale për të promovuar partneritetin dhe bashkëpunimin e sinqertë në mes të sektorit të biznesit, iniciativave qytetare dhe organizatave joqeveritare, si dhe të demonstrojë publikisht përgjegjësinë shoqërore të afarizmit (Corporate Social Responsibility), nocion ky jo shumë i njohur tek ne.



Kategoritë e FIDES

Çmimi FIDES për kontribut në nivel kombëtar i dhurohet kompanisë e cila në mënyrë sistematike dhe të kujdesshme përkrahë aktivitetet dhe projektet e interesit të përbashkët. Kjo është kompani që ka një strategji ekzistuese për të investuar në të mirën e përbashkët. Drejtimi filantropik i kompanisë mund të shërbejë si model pozitiv dhe inspirues për investimet strategjike në komunitet, me ç'rast një qasje e tillë është e mishëruar në projektet më të rëndësishme dhe më relevante që kompania ka përkrahur gjatë vitit.



Çmimi FIDES për kontribut komunitetit lokal ku vepron kompania i dhurohet kompanisë e cila shquhet për ndihmën që ka dhënë në zgjidhjen e problemeve ose adresimin e nevojave të komunitetit, qytetit, ose regjionit në të cilin operon. Përveç tjerash, kompania është në dijeni për rëndësinë e iniciativave të vogla dhe zhvillimit të grupeve të marginalizuara lokale, me ç'rast kompania provon të ndihmojë dhe riaktivizojë grupet e tilla. Ky çmim ndahet për të kurajuar dhe drejtuar të tjerët të bëjnë investime dhe t'i kthejnë investimet pikërisht në lokacionin në të cilin janë të vendosur dhe në të cilin ata kryesisht operojnë.



Çmimi FIDES për kontributin e mediave i dhurohet shtëpise mediale ose gazetarit/es, artikujt, shtojcat ose performimet e të cilëve në mënyrë të veçantë kanë kontribuar në përmirësimin dhe zhvillimin e kulturës filantropike dhe të bëmërisisë gjatë vitit në Kosovë. Duke kuptuar rëndësinë e mediave në shoqëri, ky çmim do të kurajoj më tutje gazetarët që t'i adresohen kësaj çështjeje dhe në mënyre aktive ta promovojnë atë.





Pjesëmarrësit në konkurs Çmimi për kontributin e kompanisë në nivel kombëtar

Në vijim janë paraqitur kompanitë, të cilat kanë aplikuar për këtë çmim dhe kontributi i dhënë nga to:

ISES UNIVERSUM – ofrimi i bursave për studentët më të dalluar, si dhe përfshirja në sistemin e arsimit të lartë të të rinjve me gjendje të rëndë ekonomike, veteranët e UÇK-së dhe të punësuarit në FSK.

LESNA shpk – nominuar nga Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës. Ka përkrahur duke ofruar ndihmë në vlerë prej 96.000 nevojtarëve, si dhe ka kontribuar në bashkëpunimin me Qeverinë dhe PTK-së për ndërtimin e disa shtëpive për nevojtarët.

IPKO – nominuar nga SOS Fshati i Fëmijëve – Kosovë. Ka përkrahur organizatën joqeveritare SOS Fshati i Fëmijëve duke kontribuar në përmirësimin e kushteve jetësore të fëmijëve.

MERIDIAN Corporation L.L.C – ka bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme me institucionet relevante si Kryqi Kuq, shoqata humanitare “Nënë Tereza”, SOS Kinderdorf, duke i mbështetur në mënyrë financiare dhe me shërbime.

DATA PROJECT ELECTRONICS - ka përkrahur aktivitete të ndryshme me një rëndësi të veçantë në shoqëri, duke kontribuar në vlerë prej 120.000 €

Raiffeisen Bank në Kosovë – ka përkrahur në mënyrë të vazhdueshme projektet të cilat do të kontribuonin në të mirën e përbashkët. Gjelbërimi i hapësirave publike, sigurimi i rrethojave të shkollave, renovimi i Sahat Kullës në Prishtinë, janë disa nga projektet të cilat RBKO ka përkrahur.

FAN-shpk – nominuar nga Qerim Ademi. Ka kontribuar në dhënien e materialeve që prodhon fabrika, si dhe ka ndërtuar 2 shtëpi për nevojtarët.

DUKAGJINI – nominuar nga American Council for International Education – Kosovo American Education Fund. Ka mbështetur në mënyrë financiare studentët duke dhënë bursa për studime jashtë vendit, personat



me nevojë për trajtim mjekësor, si dhe ndërtimin e qytetit të Pejës.

COMMAG Kaçaniku – nominuar nga OJQ "Konsumatori". Ka kontribuar në mënyrë të vazhdueshme lidhur me mbrojtjen e të drejtave, interesave dhe dinjitetit të konsumatorit.

Kolegji Victory – përmes ofrimit të shërbimeve, dhënies së bursave dhe ofrimit të donacioneve ka kontribuar për zhvillimin dhe rimëkëmbjen e shoqërisë, sidomos pjesës së prekur nga lufta.

Pro Credit Bank – ka kontribuar duke mbështetur shoqërinë në mënyra të ndryshme, dhe disa nga to përfshijnë: organizimi i lojërave ProKid Games, mbështetja financiare e OJQ-së "Vita-Jeta", mbështetja e SOS Kinderdorf, Teatrit Kombëtar të Kosovës, mbështetja e aktiviteteve tjera sportive dhe edukative.

TEB sh.a – ka përkrahur qytetin e Prizrenit duke shtypur hartën e qytetit dhe duke mundësuar zhvillimin e turizmit në Prizren. Ka mbështetur financiarisht shumë festivale, sportin si dhe tekstin shkollor të disa shkollave

Posta dhe Telekom i Kosovës sh.a – ka kontribuar në ndërtimin e 45 shtëpive, dhënies së bursave për 58 studentë, ka mbështetur financiarisht Qendrën Klinike Universitare, ka mbështetur sportin, organizatat e dala nga lufta etj.

Atele Ardita – nominuar nga NTP "Data Project Electronics". Ka trajnuar 240 femra të bizneseve, ka inkurajuar pjesëmarrjen e 300 femrave në garën për përzgjedhjen e "Femrës më të suksesshme në biznes"

RTV 21 – Me emisione dhe shërbime në vazhdimësi ka kontribuar në luftimin e varfërisë, luftimin e dhunës ndaj gruas, ngritjen e nivelit të arsimit formal dhe joformal, luftimin e kancerit në gji, ngritjen e vetëdijes për shëndetin.

ETC – nominuar nga OJQ "My Production". Me iniciativën e organizatës jo-qeveritare "My Production" janë ndërtuar 14 shtëpi dhe ETC ka përkrahur me produktet e veta këto familje.



Nota Brilliant & Nota Center – nominuar nga OJQ “My Production”. Ka ndihmuar në mënyrë të vazhdueshme familjarët në nevojë, duke iu bashkangjitur kontributit të organizatës jo-qeveritare “My Production” dhe duke mbështetur me gjërat e nevojshme për shtëpi.

Blakqori Commerce - nominuar nga OJQ “My Production”. Ka ndihmuar në mënyrë të vazhdueshme familjarët në nevojë, duke iu bashkangjitur kontributit të organizatës jo-qeveritare “My Production” dhe duke mbështetur me orendi për shtëpi.

*Të gjitha të dhënat e paraqitura janë formuluar në bazë të aplikacioneve të kompanive.





Çmimi FIDES për kontribut komunitetit lokal

Në vijim janë paraqitur kompanitë, të cilat kanë aplikuar për këtë çmim dhe kontributi i dhënë nga to.

N.M.I.Q Montcommerce shpk – nominuar nga OJQ “CBDC” nga Gjakova. Ka ndihmuar komunitetin duke ndihmuar në përmirësimin e mjedisit jetësor, duke angazhuar të rinjtë në sport, duke ndihmuar në botime të librave.

“Adesign” Prishtina – ka dhuruar shërbimet e veta si donacion dhe kontribuar financiarisht në projektimin e dhjetë shtëpive të lagjes së komunitetit RAE, si dhe si donacion ka bërë projektimin e Kishës Pentakostale Evangjeliste.

NQ “Termokosi” sh.a – përmes Odës Ekonomike të Kosovës ka ndihmuar financiarisht të varfërit, si dhe ka kontribuar duke ndihmuar në zhvillim energjetik të Kosovës.

Raiffeisen Bank në Kosovë - ka përkrahur në mënyrë të vazhdueshme projektet të cilat do të kontribuonin në të mirën e përbashkët. Gjelbërimi i hapësirave publike, sigurimi i rrethojave të shkollave, renovimi i Sahat Kullës në Prishtinë, janë disa nga projektet të cilat RBKO ka përkrahur.

Sharr Beteiligungs GmbH – duke mbështetur financiarisht, Sharrcem ka kontribuar në përmirësimin e sportit kosovar, instalimin e kabllit elektrik në Hani i Elezit, si dhe mbështetje tjera financiare në art, projekte edukimi dhe infrastrukturë.

TREPÇA – ka ndihmuar ish-punëtorët, ka kontribuar në përmirësimin e opinionit për Mitrovicën, si dhe ka patur ndikim pozitiv në përmirësimin e dëmeve të shkaktuara nga industria dhe përpunimi.

ABA English School – nominuar nga Adnona Bekteshi. Ka ndihmuar duke dhënë ndihmë financiare për shoqatën FENIKS lidhur me ndërtimin e shtëpive, si dhe duke iu mundësuar fëmijëve të dëshmorëve shkollim falas.

Pro Credit Bank – ka kontribuar financiarisht në shumë projekte, të cilat kanë përmirësuar jetën e qytetarit në Kosovë. Dhënia e librave, bursave të studimit, përkrahja e edukimit në përgjithësi, sportit dhe kulturës.



Kujtesa Net – nominuar nga HANDIKOS. Ka vënë në dispozicion të gjitha shërbimet e veta për kabinetet e disa shkollave në komunën e Prishtinës, si dhe ka kontribuar në avancimin dhe trajnimin e kurseve të ndryshme kompjuterike për personat me aftësi të kufizuara.

Nota Brilliant & Nota Center – nominuar nga OJQ “My Production”. Ka ndihmuar në mënyrë të vazhdueshme familjarët në nevojë, duke iu bashkangjitur kontributit të organizatës jo-qeveritare “My Production” dhe duke mbështetur me gjërat e nevojshme për shtëpi.

*Të gjitha të dhënat e paraqitura janë formuluar në bazë të aplikacioneve të kompanive.



Çmimi FIDES për kontributin e mediave

Në vijim janë paraqitur kompanitë, të cilat kanë aplikuar për këtë çmim dhe kontributi i dhënë nga to.

Radio Televizioni 21 – emisioni “Edhe unë jam Kosovë” – nominuar nga Gendra Kosovare për Studime Gjinore. Përmes emisioneve të ndryshme, ka dhënë një kontribut të fuqishëm në ngritjen e vetëdijes së shoqërisë kosovare. Emisioni “Edhe unë jam Kosovë” ka tërhequr vëmendjen e shumë organizatave dhe bizneseve dhe ka shtyrë ata që të kontribuojnë në këtë drejtim.

RTV 21 – Me emisione javore dhe të vazhdueshme televizive ka dhënë një shtytje të fuqishme drejt interesimit

të sektorit të biznesit në dhënien e ndihmës për familjet skamnore, zbutjen e varfërisë, si dhe luftën e të gjitha formave të diskriminimit.

RTK – emisioni “ Lidhja Mes Nesh” – nominuar nga organizata jo-qeveritare “My Production”. Ky emision ka mundësuar sensibilizimin e bizneseve kosovare në realizimin e emisionit, i cili ka patur për qëllim ndihmën e familjeve skamnore, duke iu ndërtuar shtëpi përmes donacioneve të kompanive.

*Të gjitha të dhënat e paraqitura janë formuluar në bazë të aplikacioneve të kompanive.



Anëtarët e Komisionit Përzgjedhës të Çmimit FIDES

Adriatik Kelmendi

Adriatiku është Kryeredaktor në KTV Kohavision. Ai Magjistër i Medias dhe Komunikimit nga Goldsmiths - Universiteti i Londrës në Mbretëri të Bashkuar. Është ligjërues në Fakultetin e Komunikimit Masiv në Univerzitetin "AAB Riinvest" në Prishtinë. Të njëjtën, ai më parë e ka bërë edhe në fakultetin e gazetarisë "Faik Konica" në Prishtinë. Gjatë 1998-2004 ai ishte gazetar dhe redaktor përgjegjës në të përditshmen "Koha Ditore" – gazeta më e lexuar në gjuhën shqipe në Kosovë. Gjatë 1999 – 2003 dhe 2008-2009 ai punoi si reporter/korrespondent në "American Radio Works", njësi e dokumentarëve në Radion Publike të Minesotës dhe Radion Kombëtare Publike në SHBA. Ai ka fituar shumë çmime kombëtare dhe ndërkombëtare gjatë karrierës së tij gazetare, si dhe ka përfunduar të konsiderueshme në editimin e librave dhe publikimeve të ndryshme.

Agim Shahini

Agimi është ekonomist me profesion dhe që nga viti 2002 është kryetar i Aleancës Kosovare të Bizneseve. AKB është shoqata kryesore e bizneseve vullnetare në Kosovë që përfaqëson mbi 5200 biznese me 23 shoqata, dhe e cila i shërben komunitetit të biznesit përmes avokimit, trajnimeve dhe promovimit të produkteve me qëllim të zhvillimit të ekonomisë vendore. Gjatë periudhës 2000 – 2002, ai ishte kryetar i Shoqatës Afariste të komunës së Vushtrrisë. Gjatë kësaj kohe ai ishte i angazhuar në implementimin e Projektit DELTA për zhvillimin e planit strategjik për komunën e Vushtrrisë. Ai është i certifikuar për ZHEL në institutin për shoqëri të hapur në Budapest. Ka marrë pjesë në shumë takime dhe konferenca vendore dhe ndërkombëtare të rëndësishme ku e ka përfaqësuar sektorin privat.

Astrit Istrefi

Astriti iu bashkua organizatës Saferword si Koordinator për Kosovë, pas nëntë viteve përfundim në zhvillim të komunitetit, asistencë humanitare, siguri në komunitet dhe zhvillim të shoqërisë civile. Ai më parë ka punuar për Forumin për



Iniciativa Qytetare (FIQ) dhe East West Management Institute. Ai poashtu ka punuar për departamentin e zgjedhjeve të OSBE, si dhe në SHBA me IOM për zgjedhjet në Irak, 'votimi jashtë vendit', dhe më vonë me IOM në Afganistan. Gjatë luftës në Kosovë, Astriti ka punuar si vullnetar në koordinimin e ndihmës humanitare dhe ofrimit të strehimit për refugjatët Kosovar në Shqipëri. Ai është shumë aktiv në fushën e shoqërisë civile dhe asaj kulturore në Kosovë.

Ilaz Ramajli,

Ilazi është me profesion Avokat dhe Partner Menaxhues në Firmën Juridike Ramajli & Partners në Prishtinë. Ai dhe fima e tij juridike janë të specializuar në fushat si ajo e Ligji për shoqëritë tregtare, ekspertiza e kontratave komerciale, e drejta dhe procedurat administrative, ligjin për OJG-të etj. Klient të firmës Juridike Ramajli dhe Partnerët janë një numër i konsiderueshëm i shoqërive tregtare, institucione financiare dhe bankare dhe OJQ, si ato të vendit ashtu edhe të huaja. Ka qenë anëtarë i Komisionit Kushtetues i Republikës së Kosovës gjatë vitit 2007 dhe 2008. Më herët ka shërbyer si përfaqësues diplomatik i Republikës së Kosovës në Tiranë (1995-1999), ka qenë nënkryetar dhe Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës (1989 – 1992), anëtar dhe Sekretar i Qeveris së Kosovës (1986 -1989) dhe Kryetar i Gjykatës komunale në Kaçanik (1982-1986).

Inge Baanders

Pas punës së fundit në Ambasadën e Mbretërisë së Holandës në zhvillimin e programit të asistencës, Inge tani është i angazhuar në shumë projekte në Kosovë që kanë të bëjnë me zhvillimin e shoqërisë civile.

Gjatë zgjedhjeve të 15 nëntorit, ajo ishte monitoruese e zgjedhjeve në komunën e Shtërpces. Ajo është anëtare e përkushtuar e Asociacionit Holandez Studentor të Kombeve të Bashkuara (Dutch United Nations Student Association -DUNSA). Momentalisht, ajo është anëtare e komisionit të konferencës së DUNSA-s, dhe është duke menaxhuar organizimin e konferencës së vitit, me temë 'A Struggle for Peace; konferencë për globalizimin, zhvillimin dhe të drejtat njerëzore. Në Shkurt 2009, ajo iu bashkua një vizite pune në OJQ-në Daneze IKV Pax Christi në Kosovë. Vizita e saj ishte prezantimi me botën e zhvillimit të bashkëpunimit në Kosovë, gjë që ndikoi në interesimin e saj për angazhim të mëtutjeshëm në këtë rajon.



Jeta Xharra

Jeta është themeluese dhe udhëheqëse e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese në Kosovë. Që nga viti 2005 Jeta është moderatore dhe redaktore e emisionit më të shikuar për çështje aktuale në Kosovë "Jeta në Kosovë". Para kësaj ajo udhëhoqi zyrën e Institutit për Raportim të Luftës dhe Paqes, organizatë mediale nga Londra. Gjatë luftës në Kosovë ajo udhëhoqi byronë e lajmeve të BBC-së dhe punoi për BBC-në si producente lokale në Kosovë, Shqipëri e Maqedoni. Në Londër Jeta ka punuar dy vjet në Shërbimin Botëror të BBC-së si asistente e redaktorit përgjegjës dhe ka botuar artikuj në gazetat angleze si Ekonomisti, The Independent, Jane's Intelligence Review dhe Daily Telegraph. Jeta ka magjistruar në Studime të Luftës nga Universiteti Mbretëror në Angli dhe në Skenar të Filmit nga Instituti i Londrës.

Nora Ahmetaj

Nora është konsulente e pavarur që merret me të drejtat e njeriut, transformimin e konfliktit dhe studime zhvillimore. Përvoja e punës mëse dhjetëvjeçare nënkupton angazhimin e hershëm të saj në demokraci dhe të drejtat e njeriut në Kosovë, parandalimin e konfliktit në Serbinë jugore, dhe promovimin e demokracisë dhe shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor. Ajo ka menaxhuar krijimin e projekteve më të rëndësishme të UNDP-së, Raportet e Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2006-08. Ajo mori titullin Master me temën Paqja dhe Transformimi i Konfliktit në Universitetin Tromso të Norvegjisë. Përveç ekspertizës me programet dhe projektet e Komisionit Evropian IPA dhe UNDP-së në Ballkan, si shkollimi në Carr Center Fellow në Universitetin Harvard–Shkollën Qeveritare Kennedy, ajo është trajnuar në aplikimin e hulumtimeve të nivelit më të lartë në zgjidhjen e problemeve dhe politikave publike për të drejtat e njeriut.

FIDES Award Ceremony



Fides

Çmimi për Filantropinë Korporate
2008-2009

1 December 2009, Prishtina



Corporate philanthropy means the support given by companies/enterprises to non-profit organizations and institutions of culture, social or health care, in money, products or services. Corporate philanthropy is a part of corporate social responsibility and is a cross cut between philanthropy and corporate social responsibility.

Corporate Social Responsibility

It is a broadly understood concept of company management, which “keeps the balance between social and economic objectives” that aims at setting the highest life standards, along with protection of company profitability, for people inside the company and outside of it“. Corporate social responsibility means that companies/enterprises behave in an ethical manner, respect the laws, employees, clients, consumers, partners and suppliers.





...honest engagement for mutual trust...



FIDES award shall be granted to the company which systematically and carefully supports activities and projects of common interest. This is a company that possesses an existing strategy for investing towards a common good. Philanthropic orientation of a company may serve as a successful and inspiring model for strategic investments in the community, an approach which is embodied in important projects that a company has supported during the year.

The objective of this prestigious award is to publish the names of companies and enterprises that have given financial support to different forms of non-profit organizations and to ideas of the society that have contributed for the common good. In this way the FIDES award shows a model that can be followed by the business world.

The organization of giving the award and the ceremony itself is an ideal opportunity to promote a sincere partnership and cooperation between the business sector, civic initiatives and non-governmental organization and to publicly demonstrate Corporate Social Responsibility, a notion that is not very well known here.



FIDES Categories

FIDES award for the national level shall be granted to the company which systematically and carefully supports activities and projects of common interest. This is a company that possesses an existing strategy for investing for a common good. Philanthropic orientation of a company may serve as a successful and inspiring model for strategic investments in the community, an approach which is embodied in the most important projects that a company has supported during the year.



FIDES award for contributing to a local community where the company operates shall be granted to the company that is marked for its help in solving the problems or addressing needs of community, city, or region that a company operates. Besides others, the company is informed on the importance of small initiatives and development of marginalised local groups, in which case, the company tries to help and reactivate such groups. This award is granted in order to encourage and direct others to invest and return investments, exactly in the location they are based and they operate.



FIDES award for media contribution shall be granted to the media group or journalist, whose articles or performance has contributed specifically towards improving and developing a philanthropic culture and charity in Kosovo. Understanding the importance of media presence in the society, this award shall encourage journalists to address this issue and actively promote it.





Participants in the competition

Main award for the company's contribution at a national level

The following companies have applied for this award and have contributed as follows:

ISES UNIVERSUM – scholarships offered for distinguished students, as well as their inclusion in the higher education system of young people with difficult socio-economic conditions, KLA veterans and KSF employees.

LESNA – nominated by the Kosovo Association of Wood makers. It has given financial support of 96.000 € to people in need and has contributed to the agreement of the government and PTK in building houses for people in need.

IPKO – nominated by the SOS Children's Village – Kosovo. It has supported the non-governmental organization SOS Children's Village by contributing in improving the children's life conditions.

MERIDIAN Corporation L.L.C – had continuously cooperated with relevant institutions like Red Cross, humanitarian society "Mother Theresa", SOS Kinderdorf, by supporting them financially and other services.

DATA PROJECT ELECTRONICS – has supported different activities of special importance to the society by contributing an amount of 120.000 €

Raiffeisen Bank in Kosovo – has continuously supported projects which contributed to the common good. Greening public spaces, suppling school fences and the renovation of Sahat Kulla in Prishtina are some of the projects supported by RBKO.

FAN-L.L.C – nominated by Gerim Ademi. It has contributed in supplying with materials produced by the factory and has built two houses for people in need.

DUKAGJINI – nominated by the American Council for International Education – Kosovo American Education Fund. It has financially supported the students by giving them scholarships for studies outside the country. It has supported the medical procedures for persons treated outside the country and has also supported constructions in Peja.



COMMAG Kaçaniku – nominated by the NGO “Konsumatori”. It has continuously contributed to the protection of rights, interests and dignity of the consumer.

College Victory – through offering services, scholarships and donations, it has contributed to the society development and recovery, especially to categories affected by war.

Pro Credit Bank – its contribution lies in supporting the society in different manners, including: organization of games called ProKid Games, financial support to the NGO “Vita-Jeta”, support to SOS Kinderdorf, the National Theatre of Kosovo and support to sport and educational activities.

TEB – has supported the city of Prizren by printing the city map and enabling touristic development in Prizren. It has financially supported many festivals, sports and text books for schools.

Post and Telecom of Kosovo – it has contributed to the construction of 45 houses, scholarships for 58 students and has financially supported the University Clinical Centre; it has supported sports, organizations of war categories etc.

Atele Ardita– nominated by NTP “Data Project Electronics”. It has trained 240 business women and has encouraged the participation of 300 women in the competition for selection of “The most successful business woman”

RTV 21 – by transmitting TV shows it has contributed in fighting poverty, violence against women, enhancing of formal and non-formal education level, fight against breast cancer, and conscience awareness on health issues.

ETC – nominated by the NGO “My Production”. Upon initiative of the non-governmental organization “My Production”, 14 houses have been built and ETC has supported the families with its products.

Nota Brilliant & Nota Center – nominated by the NGO “My Production”. It has continuously supported families in need by joining non-governmental organization “My Production” and supporting with necessary domestic products.

Blakqori Commerce – nominated by the NGO “My Production”. It has continuously supported families in need by joining “My Production” and supporting the families with house furniture.

*All data represented here is formulated based on the applications submitted by the companies.



FIDES award for contributing at a local community

The following companies have applied for this award with the following contribution:

N.M.I.Q Montcommerce L.L.C – nominated by the NGO “CBDC” from Gjakova. It has helped the community in improving the living environment by including young people into sports and by helping to publish books.

“Adesign” Prishtina – has given its service for free and contributed financially in projecting ten houses in the district of the Roma, Ashkali and Egyptian community. It has also given a donation to the projection of the Evangelist Pentecostal Church.

“Termokosi” J.S.C – through the Kosovo Chamber of Commerce it has financially supported poor people and has contributed to the energetic development of Kosovo.

Raiffeisen Bank in Kosovo - has continuously supported projects which contribute to the common good. Greening public spaces, supply with school fences and the renovation of Sahat Kulla in Prishtina, are some of the projects supported by RBKO.

Sharr Beteiligungs GmbH – by giving financial support, Sharrcem has contributed to the improvement of Kosova sports, instalment of an electrical cable in Hani i Elezit municipality and has given other financial support to project of arts, education and infrastructure.

TREPÇA – has helped ex-employees, contributed to the image improvement of Mitrovica and has positively affected in recovery of damage caused by industry and recycling.

ABA English School– nominated by Adnona Bekteshi. It has given financial support to society FENIKS in building houses, and in enabling a free tuition/school to the children of martyrs.

Pro Credit Bank – has contributed financially in many projects that have improved the life of Kosovo citizens. Its support lies in giving books, scholarships, education support and to culture and sport in general.



Kujtesa Net– nominated by HANDIKOS. It has put into disposal all its services for school labs in the Prishtina municipality, and has contributed to the advancement and training in computer disciplines for persons with disabilities.

Nota Brilliant & Nota Center – nominated by the NGO “My Production”. It has continuously supported families in need, by joining the non-governmental organization “My Production” and supporting families with necessary domestic products.

* All data represented here is formulated based on the applications submitted by the companies.



FIDES award for media contribution

The following companies have applied for this award, with the following contribution:

Radio Television 21 – TV program “Edhe unë jam Kosovë” (I am Kosovo too) – nominated by the Kosovo Centre for Gender Studies. Through different TV shows, it has given a strong contribution in raising awareness of Kosovo society. The TV show “Edhe unë jam Kosovë” has attracted the attention of many organizations and businesses and has inspired them to contribute on this issue.

RTV 21 – Its weekly and continuous programs have strongly affected the interest of business sector in helping poor families, in reducing poverty and in fighting all forms of discrimination.

RTK – TV show “ Lidhja Mes Nesh” (The bond between us)– nominated by the non-governmental organization “My Production”. This show has made Kosovo businesses help to make the show with an aim to help poor families, by building their houses through donations of companies.

* All data represented here is formulated based on applications submitted by the companies.



Members of the Selection Committee for FIDES Award

Adriatik Kelmendi

Adriatik is editor in chief in KTV Kohavision. He holds a MA in Media and Communication from Goldsmiths - University of London in the United Kingdom. He is a lecturer in the Faculty of Mass Communication at the University "AAB Riinvest" in Pristina. Previously he has done the same at the Faculty of Journalism "Faik Konica" in Prishtina. During 1998-2004 he was reporter and responsible editor in the daily "Koha Ditore" - the most read Albanian language newspaper in Kosovo. During 1999 - 2003 and 2008-2009 he worked as a reporter / correspondent for "American Radio Works", the documentary unit on Minnesota Public Radio and National Public Radio in the U.S.. He has won many national and international awards during his journalist career and has considerable experience in editing books and various publications.

Agim Shahini

Agim is an economist and since 2002 he is Head of Kosovo Business Alliance (AKB). AKB is the main association that serves the business community through advocacy, training and promoting products with the goal to develop local economy. During 2000 – 2002, he served as President of the Business Association of Vushtrri municipality. During this period he was engaged in implementing the Project called DELTA, for developing the strategic plan for the municipality of Vushtrria. He is certified for ZHEL at the institute for open society in Budapest. He has participated in many meetings, important local and international conferences, where he represented the private sector.

Astrit Istrefi

Astrit joined Saferworld as a Kosovo-based Project Co-ordinator after nine years experience in community development, humanitarian assistance, community safety and civil society development. He has previously worked in Kosovo for the Forum for Civic Initiatives and the East West Management Institute. He has also worked for the



OSCE's election department and with the International Organisation for Migration on Iraq 'out-of-country voting' and in Afghanistan. During the Kosovo war, Astrit had a voluntary role in co-ordinating humanitarian assistance and providing accommodation for Kosovar refugees in Albania. He is active in a number of civic and cultural organizations in Kosovo.

Ilaz Ramajli,

Ilaz is a lawyer and a Managing Partner at the Law Firm Ramajli & Partners in Prishtina. He and his law company are specialised in areas like law on trade societies, commercial contracts, rights and administrative procedures, law on NGOs etc. Clients of law firm Ramajli and Partners are a considerable number of trade societies, financial and banking institutions and NGOs, local and international ones. He was a member of the Constitution Committee of the Republic of Kosovo during 2007 and 2008. He served as a diplomatic representative of the Republic of Kosovo in Tirana (1995-1999), as vice-president and president of the Assembly of the Republic of Kosovo (1989 – 1992), member and Secretary of the Government of Kosovo (1986 -1989) and Chairman of the Municipal Court in Kaçanik (1982-1986).

Inge Baanders

After her most recent job at the Embassy of the Kingdom of Netherlands on the development assistance program, Inge is at the moment engaged in different projects in Kosovo focusing on civil society development. During the elections of 15th of November, she was an election monitor in the municipality of Shterpce. She is a committed member of the Dutch United Nations Student Association.

Currently, she is a member of DUNSA's conference committee, charged with the organisation of the 2010 conference 'A Struggle for Peace; a conference on globalisation, development and human rights'. In February 2009, she joined a working visit of the Dutch NGO IKV Pax Christi to Kosovo. Her visit was an introduction to the world of development co-operation in Kosovo and further stimulated her interest in being engaged in the region.

**Jeta Xharra**

Jeta is founder and director of the Balkans Insight and journalism Research Network in Kosovo. From 2005, Jeta has been a moderator and editor of the most viewed TV show on actual issues in Kosovo, called "Jeta në Kosovë". Before this, she directed the office of the Institute for Reporting War and Peace, a medial organization from London. During the war in Kosovo, she directed the BBC news bureau and worked for the BBC as a local producer in Kosovo, Albania and Macedonia. Jeta worked in London for the BBC World Service as an assistant to the editor-in-chief and has published articles in English newspapers like the Economist, The Independent, Jane's Intelligence Review and Daily Telegraph. Jeta has an MA degree in War Studies at the Royal University in England and a degree in Film Scenarios at the London Institute.

Nora Ahmetaj

Nora is a freelance consultant who specializes in human rights, conflict transformation and development studies. A more than ten-year professional experience implies her previous involvement in democracy and human rights in Kosovo, conflicts prevention in southern Serbia, and promotion of democracy and civil society in the Western Balkans. She managed production of UNDP's flagship projects, the Kosovo Human Development Reports 2006-08. She earned a Master degree of Phil. in Peace and Conflict Transformation from Tromso University in Norway. In spite of her expertise with the EC/IPA and UNDP program/projects in the Balkans, as the Carr Center Fellow at Harvard University-Kennedy School of Government she was trained to apply first-class research to the solution of public policy and human rights problems.

Special thanks to:



This project is financially supported by the
Rockefellers Brothers Fund





Forumi për Iniciativa Qytetare, FIQ
Rr.Bedri Pejani 7/A, 10 000 Prishtinë, Kosovë
www.fiq-fci.org